

Ambasadorja e Shqipërisë nxjerr mashtrimin e Qeverisë

Zbulohet skandali i qeverisë me krizën humanitare në kufi me Greqinë. Kryeministri dhe ministria e Jashtme u njoftuan që më datën 5 gusht për problemet që do krijoheshin në pikën kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës. Qeveria nuk mori asnjë masë dhe mashtroi qytetarët për të fshehur neglizhencën e tmerrshme, kur mijëra qytetarë mbetën me netë të tëra në radhë si refugjatët sirianë të ikur nga lufta. Dikush duhet të japë dorëheqjen ose SPAK duhet të nisë hetimet për shpërdorim detyre

PAGE 3

Presidenti Ilir Meta vlerëson ish-Presidentin, Rexhep Meidani me "Dekoratën e Flamurit Kombëtar"



Në foto: Presidenti Ilir Meta dhe ish-Presidenti Rexhep Meidani, dje gjatë ceremonisë së dekorimit të zhvilluar në Presidencë.

PAGE 16

FJALIMI

Prof. Dr. Rexhep Meidani, model frymëzues i shtetarit dhe politikanit të përgjegjshëm

Nga Ilir Meta

PAGE 8

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I LSI

Endrit Braimllari: Qeveria "Rama" është në grahmat e fundit

Intervistoi: Herion Mesi

PAGE 4

SEKRETARI I PD PËR ÇESHTJET NDERKOMBËTARE

Arben Kashahu: Rama shpërdoroi detyrën duke lejuar krizën në Kakavijë

PAGE 4

STRATEGJIA PËR VJESHTË-DIMËR

Ministria Manastirliu: Dyfishim të testeve, falas vaksina e gripit

PAGE 9

ISH-DEPUTETJA E PD-SË

Tabaku: Në 7 vjet Rama nuk mbajti asnjë premtim, vetëm zhyti vendin në krizë

PAGE 6

KRYEMINISTRI MUNGONË NË DEKORIMIN E MEIDANIT

Tedi Blushi: Rama ishte i ftuar, por po merret me Bjellorusinë

PAGE 16

OPINION

Emigrantët, bijtë e mohuar!

Nga Ermir Gjinihi

PAGE 7

ANALIZË

(Pa) fajësia e grekut

Nga Artan Hoxha

FORUM

Në 30 vjetorin e poezisë "Kujt" të Gjekë Marinaj, botuar në gazetën "Drita" më 19 gusht 1990


Nga Arben Çoka

PAGE 12

Në 30 vjetorin e poezisë "Kuajt" të Gjekë Marinaj, botuar në gazetën "Drita" më 19 gusht 1990

Nga Arben Çokaj

Kur poezia "Kuajt" mori jetë, Shqipëria ishte e mbyllur për 45 vjet dhe ishte një shembull thuajse unik në botë, se si një vend i vogël në Ballkan, i kishte mbyllur plotësisht të gjitha portat e komunikimit me botën përreth. Kjo gjendje kaq e rënduar psikologjike e sociale, ky terror i pajustificuar për jetën kulturore shqiptare në atë kohë, krijoi një klimë mbytëse auto-censure, dhe në shumë plane shihej dështimi i atij sistemi, që kishte kufizuar lirinë e njerëzve ndërsa komunistët po e mbanin me forcë e terror. Në këto kushte, një poeti ri malësor, nga Bruti i Kastriotit, me emrin Gjekë Marinaj, guxoi, ndoshta nisur edhe nga një naivitet i habitshëm, që i shoqëron gjenitë, dhe botoi 4 poezi në gazetën "Drita" të "Lidhjes së shkrimtarëve", ku poezia e fundit e atij cikli të përmbledhur nga poeti Ndoc Gjetja, ishte "Kuajt". Ishte guxim i madh nga poeti i ri, por edhe nga botuesit e gazetës Drita, që nuk kaloi në heshtje. "Kuajt" ishin një britmë vërtetësie në qiellin e errët shqiptar të kohës,



një "vintergæk", si i thonë danëzët "luleborës", që hapi siparin e lëvizjes studentore shqiptare kundër diktaturës në Shqipëri dhe sjelljen e demokracisë në vend. Poezia me 21 vargje ishte mjaft goditëse për sistemin komunist në Shqipëri. Të nesërmen

e botimin të poezisë, nën idenë se "shteti e zë lepurin me qerre", Sigurimi i shtetit i çon fjalë poetit të ri atje në Brut, që të paraqitet në Degën e Brendshme në Shkodër. Gjekë e kuptoi se kjo ishte një thirrje, që mund ta dëmtonte përjctë. Padyshim se mund

ta prisnin tortura çnjerëzore, dhunë e pajustificuar, poshtërim i tejskajshëm e rrezikim i jetës. Në këtë konflikt të madh me vetveten, duke e parë rrezikun në sy, ai pafolur me shumë njerëz, e ndau mendjen, që të arratisej për në Jugosllavi. Mori disa libra me vete dhe u nis atë natë, meqë zonën e njihte mirë dhe iku... Ishte një veprim mjaft i guximshëm prej tij, si një alternativë e vetme drejt lirisë, drejt jetës. Kush guxon - fiton. Në atë kohë, kishte plot raste, që njerëzit kapeshin duke ikur në kufi dhe torturoheshin e vriteshin si qentë...

Në Beograd, nga kampi i refugjatëve në Hvala, Gjekë gjeti mundësinë të kontaktonte me Ambasadorin Amerikan në Beograd. Dhe në takim me të, Gjekë i sqaron atij tragjedinë të tij personale, dhe fatkeqësinë që i solli një poezi... Me ndihmën e një përkthyesi, Gjekë ia lexon poezinë "Kuajt" ambasadorit amerikan në Beograd, dhe me të mbaruar leximin e saj, ambasadori amerikan i thotë: "Welcome to USA son". (Mirësevjen në SHBA bir.) Dhe kështu Gjekë shkoi në Amerikë... Në Amerikë i duhej të punon-

te për të mbajtur veten, e paralelisht me punën, edhe të shkollohet e të shkruajë. Kështu që me punë, me mund e sakrificë, Gjekë arriti të mbronte edhe titullin PhD në letërsinë krahasuar, dhe nga një poet i ri malësor, tashmë është shndërruar në një intelektual të rafinuar e të kuruar, dhe ka marrë edhe një pozicion si Drejtor i Përgjithshëm i MundusArtiumPress, shtëpia botuese e Universitetit të Texas, UTD. Prej 19 vjetësh, Gjekë vazhdon gjithashtu të japë mësim për letërsi.

Tani Gjekë ka një histori suksesi me vete, që filloi me një poezi kundër regjimit komunist në Shqipëri. Ai doli edhe me teorinë e tij letrare Proteus, që po futet në disa universitete për studim. Është i kompletuar në fushën profesionale dhe ka më shumë mundësi të avancojë si një intelektual shqiptaro-amerikan i një kalibri të lartë. Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të botës dhe "Kuajt" e tij nuk frymëzuan vetëm shqiptarët, studentët që e mbanin ndër duar poezinë e tij gjatë protestave të Dhjetorit '90-të, por edhe popuj të tjerë të shtypur në botë!

Klaudia Pepa, protagoniste në një film

Balerina shqiptare Klaudia Pepa, Be cila vitet e fundit po jeton në Itali, aty edhe ku ka krijuar një karrierë, ka dhënë lajmin se së shpejti do ta shohim edhe si aktore. Përmes disa postimeve në rrjete sociale, ajo thotë se është tepër e emocionuar dhe e lumtur për pjesëmarrjen e saj në një film. "Dua të ndaj me ju një lajm të bukur. Më në fund, ëndrra ime u bë realitet". Klaudia do të jetë bashkë-protagoniste me Beppe Convertinin, në një film thriller me titull "Reverse". Projekti filmik nga Giuseppe Lepore do të fillojë xhirimet në 17 gusht, në përputhje me të gjitha kërkesat e shëndetit dhe sigurisë ndaj Covid-19. Për këtë mundësi, Klaudia falenderon ndjekësit, familjen dhe skuadrën, që e ka mbështetur, si dhe menaxheren e saj, që i ofroi mundësinë për të qenë në film, Agata Imbrogiano. Pas pjesëmarrjes në Amici, Klaudia është zhvendosur prej kohës në Itali dhe ka qenë pjesë e disa videove kërcimi, në videoklipe muzikore apo si protagoniste. Filmi flet për një vrasës serial të sëmurë, i cili realizon çdo krim duke përdorur një thikë blu. Një inspektor policie, i bindur se e gjithë çmenduria e tij është një trillim, do ta marrë në pyetje duke e bërë të rrëfhet.

